



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3155/7 prot.

Datë 05/12/2025

V E N D I M

Nr. 1800/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05/12/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-60614-09-08-2025, me objekt “Furnizim Vendosje pajisje mjekësore Angiografi, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, me fond limit **66,192,000** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH**, e konvertuar në Euro: 97.14 sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025: 681.408.28** (gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tete pike njezet e tete) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.

Ankimues: Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK me NIPT L42231011L dhe adresë Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga, “Themistokli Gërmenji”, Nd. 11, H. 4, Ap.4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” me adresë Rruga “Dr. Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021,

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09-09-2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-60614-09-08-2025, me objekt “Furnizim Vendorsje pajisje mjekësore Angiografi, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, me fond limit **66,192,000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH**, e konvertuar në Euro: 97.14 sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025: 681.408.28** (gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tete pike

njezet e tete) **Euro pa TVSH** lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.

II.2. Në datë 09-10-2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 21.10.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e procedurës dhe ka njoftuar elektronikisht operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Health & Light” shpk	38,470,000	skualifikuar
2. “Medfau” sh.p.k	49,644,000	kualifikuar

Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK rezulton i skualifikuar në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Në zbatim të ligjit nr. 162/2020 për “Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, si dhe Neni 93, Pika 3 e ligjit 162/2020 “Oferta anomalisht e ulët”, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe argumentimit të dhënë nga shoqëria “Health and Light” SH.P.K., skualifikohet pasi argumentimi nuk është shoqëruar me dokumentacionin shpjegues sipas legjislacionit në fuqi.

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 29.10.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 05.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3155/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6050 e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-60614-09-08-2025, me objekt “Furnizim Vendosje pajisje mjekësore Angiografi, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, me fond limit **66,192,000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH**, e konvertuar në Euro: 97.14 sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025: 681.408.28** (gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e katerqind e tete pike njezet e tete) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshua, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3155/1, datë 06.11.2025, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datë 10.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “Medfau” shpk ka dorëzuar “Formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3155/2 prot., datë 10.11.2025.

II.8. Me shkresën me nr. 252/189 prot., datë 10.11.2025 protokolluar me tonën me nr. 3155/3 prot, datë 12.11.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Në datë 12.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “Helth & Light” shpk ka dorëzuar “Formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3155/4 prot., datë 12.11.2025.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi “Medfau” shpk, ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit me arsyetimin se: *“[...] Më tej akoma, në pikën 3 të nenit 93 të Ligjit 162/2020 ligjvënësi ka përcaktuar se: Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Po përse e ka parashikuar këtë normë ligjvënësi në pikën 3 të nenit 93 për ofertat anomalisht të ulët? Përgjigja është kjo të nderuar përfaqësues të AK: Pikërisht sepse ndodhemi përballë një situate jo të zakonshme, e cila nuk mund të sqarohet dhe/ose kuptohet nëpërmjet një komunikimi të thjeshtë dhe të ftohtë shpresor. Kjo situatë kërkon ndërveprim, komunikim dhe konsultim konkret të elementëve teknikë dhe të prodhimit që kanë çuar në ndërtimin dhe paraqitjen e një oferte anomalisht të ulët. Vetëm pas një procesi konsultimi dhe ndërveprimi ndërmjet palëve (AK&OE ofertues)*

mund të kemi një panoramë të qartë mbi ofertën anomalisht të ulët dhe shkaqet që kanë sjellë këtë ofertë dhe vetëm pas kësaj panorame të qartë mund të kryhet një vlerësim objektiv nga ana e AK. Por në rastin konkret a është kryer kjo procedurë e detyrueshme e përcaktuar në nenin 93/3 të LPP? Përgjigja është JO. Kjo përbën një shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe konkretisht rezulton se nuk është zbatuar procedura e përcaktuar në nenin 93/3 të LPP. Shkelja e ligjit nga ana e AK si pasojë ka sjellë një vlerësim të cunguar të argumentimit të ofertës së paraqitur nga ana e OE “HEALTH & LIGHT” sh.p.k., pasi në kundërshtim me procedurën dhe parashikimin ligjor të sipërcituar AK nuk ka vlerësuar drejtë dhe objektivisht elementët konkretë specifikë dhe kushtet mbi të cilat është ndërtuar oferta jonë. AK ka dështuar të respektojë normën ligjore për të konsultuar ofertën tonë anomalisht të ulët, me qëllim vlerësimin objektiv dhe në përputhje me shkaqet dhe arsyet e paraqitjes së saj. Në këto kushte vlerësojmë se kjo shkelje e procedurës dhe normave ligjore e kryer nga ana e AK e cenon vendimmarjen për skualifikimin e ofertës tonë, e për pasojë duhet të rishikohet nga Autoriteti Kontraktor [...].

[...] 2. Së dyti, në lidhje me arsyet dhe shkaqet e paraqitjes së ofertës tonë e cila ka rezultuar anomalisht e ulët, argumentojmë si vijon: a) Vlen të theksojmë faktin se kjo procedurë prokurimi është rishpallur për herë të 3-të nga Autoritetit Kontraktor, QENDRA SPITALORE RAJONALE E TIRANËS “SHEFQET NDROQI”. Fillimisht kjo procedurë prokurimi është shpallur nga AK në vitin 2024, procedurë e cila është anuluar nga KPP në Janar 2025. Më pas është rishpallur nga AK gjatë vitit 2025 dhe është anuluar nga AK në Qershor 2025. Për herë të 3-të kjo procedurë është rishpallur në datën 08.09.2025 dhe kjo është procedura e cila po zhvillohet aktualisht. Sjellim në vëmendjen tuaj se herën e parë të shpalljes së kësaj procedure prokurimi, si pasojë e një procesi ankimi, janë ndryshuar në mënyrë thelbësore specifikimet teknike të aparaturës Angiograf objekt i procedurës së prokurimit, duke i reduktuar maksimalisht ato [...].

[...] b) Në Kthimin e përgjigjes nga OE “Health Light” shp.k. ndaj shkresës nr. 252/176 prot., datë 14.10.2025 të AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, kemi parashtruar të gjithë argumentet financiare, tregtare dhe teknike për ndërtimin e ofertës tonë. Sjellim në vëmendje të AK se aparatura e ofertuar nga ne për argumentimin e ofertës është e markës Philips, një nga kompanitë më prestigjioze në botë për prodhimin e Aparaturave mjekësore dhe e testuar ndërkombëtarisht për cilësinë dhe seriozitetin e saj. Nga ana tjetër ne kemi paraqitur të gjithë argumentat dhe provat me anën e të cilave provohet katërcipërisht se ne mund ta ofrojmë produktin me atë çmim. Madje në kundërshtim me politikat tregtare dhe në dëm të kompanisë tonë, ne kemi paraqitur pranë AK edhe ofertat dhe komunikimi tregtar që disponojmë nga kompania Philips dhe kompani të tjera (për pajisjet ndihmëse e aksesoret e angiografit), duke nxjerrë dhe zbuluar elementë dhe të dhëna sensitive me karakter sekret tregtar, vetëm me qëllimin e mirë për të pasqyruar dhe argumentuar në konsultim me JU arsyet dhe argumentet e paraqitjes së ofertës tonë. Këto prova dhe argumente, jo vetëm që nuk janë marrë në konsideratë nga ana juaj, por në mënyrë të ftohtë e në kundërshtim të hapur me nenin 93/3 të Ligjit të Prokurimit Publik, AK nuk e ka zbatuar procedurën ligjore të konsultimit me shoqërinë ofertuese të ofertës anomalisht të ulët, duke gjykuar në mënyrë sipërfaqësore dhe subjektive argumentet tona [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 1 dhe 2 “Formulari i ofertës ekonomike” dhe shtojcën nr. 3 “Lista e çmimeve të artikujve”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE²

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë:

1	2	3
---	---	---

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

III.1.2 Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet Teknike:

SISTEMI I ANGIOGRAFISË DIXHITALE PËR PROCEDURAT E KARDIOLOGJISË DIXHITALE 3D SUBTRAKTUESE

C-ARM (KRAHU -C)

1.1 C-arm i montuar në dysheme , i cili lejon përdoruesit të kenë akses të lirë te pacienti nga të gjitha anët gjatë procedurës pa lëvizur pacientin

- 1.2 Rrotullimi i krahut C LAO/RAO min. $\pm 120^\circ$
- 1.3 CRA/CAU Rrotullimi i krahut C min. $50-90^\circ$
- 1.4 Shpejtësia më e lartë e rrotullimit të C-boë min. 25° në sekondë
- 1.5 Detektor i fokusit në distancë të ndryshueshme $90 - 120 \pm 1$ cm
- 1.6 C-krah thellësi min. 85 cm
- 1.7 Mundësia e pozicionimit të krahut C në raport me anën e djathtë dhe të majtë të tryezës së pacientit pa qenë nevoja të rrotullohet tavolina e pacientit, mundësia e lëvizjes së vazhdueshme të krahut C ose tavolines së pacientit në drejtimin gjatësor për të mbuluar anatomitë periferike pa lëvizur. Pacienti min 188cm
- 1.8 Sistemi duhet të mundësojë akses radial (procedurë shunt dhe PIÇ) pa rrotulluar tabelën e pacientit

Tavolina e pacientit

- 2.1 Tavolina e pacientit duhet të jetë e fiksuar në dysHEME
- 2.2 Gjatësia e tavolinës min. 288 cm
- 2.3 Gjerësia e sipërme të tavolinës min. 45 cm
- 2.4 Zhvendosja gjatësore min. 120 cm
- 2.5 Rregullim i motorizuar i lartësisë së tavolinës min 20 cm nga pika më e ulët në pikën më të lartë
- 2.6 Pjerrësia kranio-kaudale e tabelës min. $\pm 15^\circ$
- 2.7 Rrotullimi i tavolinës min. $+90 / -180^\circ$
- 2.8 Ngarkesa maksimale e tavolinës min. 220 kg
- Llampë LED 2.9 e vendosur në suportin e tavanit
- 2.10 Dyshek për tavolinën e pacientit (2 copë)
- 2.11 Thithja maksimale e tavolinës ekuivalente me 1.5 mm Al
- 2.12 Ekran me prekje për menaxhimin e sistemit, me mundësinë e detyrueshme të funksioneve të mëposhtme:
 - Menaxhimi i sistemit hemodinamik
 - Zgjedhja e metodës së dëshiruar
 - Kalimi midis Cine image dhe Map image

GJENERATOR

- 3.1 Gjenerator me frekuencë të lartë i kontrolluar nga mikroprocesori
- 3.2 Minimumi i fuqisë maksimale. 100 kE
- 3.3 Tensioni i anodës në intervalin minimal 50–125 kV
- 3.4 Vlera maksimale aktuale në modalitetin e blerjes min. 1000 mA
- 3.5 Vlera maksimale e rrymës në modalitetin e fluoroskopisë pulsore min. 30 mA
- 3.6 Ka një sistem për kontrollin automatik të ekspozimit

TUBE RREZE X DHE KOLIMATOR

- 4.0 Ka një anodë rrotulluese dhe të paktën 2 pika fokusi

4.1 Madhësia maksimale e pikës fokale të vogël. 0.4 mm-0.5 mm

4.2 Madhësia e pikës së madhe fokale MAX. 1.0 mm

4.3 Mundësia e detyrueshme e ndërrimit automatik të fokusit në rast se fokusi primar dështon dhe për nevojën për të përfunduar procedurën e filluar

4.4 Set me 3 filtra të rrezatimit me rreze x me mundësi zgjedhjeje automatike dhe manuale deri në min. 0,3 mm Cu

4.5 Sistemi i filtrave konturorë dhe spektralë

4.6 Kapaciteti termik i anodës min. 3Mhu

4.7 Kapaciteti maksimal ftohës i anodës min. 540 kHU/min

4.8 Kapaciteti maksimal i ruajtjes së nxehtësisë së kabinës min. 2.89 Mhu

4.9 Kontrolli automatik i ekspozimit (rregullimi automatik i të paktën parametrave të mëposhtëm: kV, mA, ms,)

DETEKTOR DIXHITAL

1. Detektor dixhital i sheshtë me rezolucion të lartë, sipërfaqe aktive prej min. 26x29 cm
2. Madhësia maksimale e pikselit. 195 μ m
3. Mbështetje e plotë 16-bit për të gjithë zinxhirin e imazhit nga detektori në monitor për imazhet 2D dhe 3D
4. Matrica e imazhit min. 1400x1500 piksele
5. Rezolucioni hapësinor min. 2,5 lp/mm
6. Materiali i detektorit a-Se ose CsI
7. DQE e detektorit min. 70%

SISTEMI I SHQYRTIMIT TË IMAZHIT NË DHOMËN E PROVIMIT

1. Monitorët e tavanit që lejojnë pozicionimin e lirë rreth tavolinës
2. Mbështetje për monitorët me mundësi lëvizjeje, vertikale, anësore dhe gjatësore dhe me mundësi rrotullimi
3. Monitor Min 4K me një diagonale 55-58", i cili njëkohësisht shfaq: "imazh të drejtpërdrejtë", imazhe referencë, imazhe nga pajisje të jashtme që gjenerojnë sinjale video analoge dhe dixhitale me një panel të dedikuar që mundëson një lidhje të tillë. aktivizoni shfaqjen e imazhit min e pajisjeve të përmendura: OCT, IVUS, hemodinamikë, FFR, ultratinguj, me monitor shtesë të pasmë minimale 19"
4. Rezolucioni i monitorit min. 3840x2160, shkëlqim deri në 500 cd/m²

SHQYRTIMI DHE SHPALLJA E IMAZHEVE NË DHOMËN E KONTROLLIT

1. . Stacion pune i pavarur me monitor LCD me ngjyra për paraqitjen e pamjes klinike dhe manipulimin në dhomën e kontrollit Dimensionet: diagonale min. Rezolucioni 21", min. 1920x1080 piksele, ndriçimi min. 270 cd/m²
2. Stacion pune për sistemin e informacionit spitalor (BIS) me 1 monitor LCD me ngjyra, diagonale min. Rezolucioni 22", min. 1920x1080 piksele, ndriçimi min. 270 cd/m²

3. Sistemi duhet të lejojë sa vijon: - Regjistrimin dhe shfaqjen e sekuencave dinamike fluoroskopike - Analizën sasiore - Aftësinë për të përdorur veglat e shënjitimit në imazhin e shfaqur në monitorin e dhomës së ekzaminimit - Transferimi në PACS (plotësisht i pajtueshëm me sistemin PACS)
4. Stacion pune shtesë të integruar ose të pavarur me min. me një monitor 24" për shikimin e imazheve gjatë ose pas bërjes së kardiologjisë dhe DSA

SISTEMI DIXHITAL DHE MËNYRAT E PUNËS

1. Sistemi operativ të paktën EIn 10 ose me mire
2. Fluoroscopi dixhitale me puls me shpejtësi nga 1 pps deri në 30 pps
3. Përpunimi i imazhit fluoroskopik në kohë reale
4. Katër mënyra të fluoroskopisë, në varësi të madhësisë së pacientit, rastit ose prioritetit të mjekut
5. DSA me filtrim dixhital në kohë reale për imazhe të vetme dhe breshëri me shpejtësi kuadri nga 1 fps në 12 fps
6. Aftësia për të krijuar një imazh të zbritur në një rrotullim
7. Blerjet dixhitale me shpejtësi kuadri nga 1 në min. 30 fps
8. Pas-përpunimi i imazhit: kontrasti/shkëlqimi, përmirësimi i skajeve, matja e distancës/këndit
9. Mundësia e filmimit të imazheve dhe shikimit paraprak të tyre përpara printimit
10. Numri më i vogël i mundshëm i imazheve të ruajtura në sistem është min. 50,000 (12 bit, 1k matricë)
11. Mundësia e ruajtjes së një seance fluoroskopike prej min. 1000 korniza
12. Shfaqja e detyrueshme e njëkohshme e dy imazheve të drejtpërdrejta (p.sh. fluoroscopi e zmadhuar + jo e zmadhuar ose Udhërrëfyesi i drejtpërdrejtë + fluoro origjinale e drejtpërdrejtë)

MENAXHIMI I SISTEMIT

1. Kontrolloni lëvizjen e krahut C dhe tryezës së pacientit
2. Pozicionimi i hapjes dhe filtrit të kolimatorit
3. Aftësia për të ruajtur dhe kujtuar pozicionin e krahut C
4. Butoni i ndalimit emergjent
5. Përzgjedhja e protokollit të organit dhe cilësimet e marrjes
6. Manipulimi i sistemit hemodinamik dhe shfaqja e parametrave hemodinamikë
7. Çiftimi i injektorëve
8. Mundësia e zgjedhjes së një imazhi referencë
9. Kontrolli i funksionit të zbritjes
10. Mundësia e leximit dhe shikimit të imazheve nga PACS në monitor në dhomën e ekzaminimit
11. Analiza sasiore e imazheve të regjistruara
12. Telekomandë në sallë që lejon lëvizjen nëpër sesione, seri, korniza dhe përzgjedhje të imazhit të referencës

13. Një pedale këmbësh me valë në sallë që mund të programohet për të kontrolluar pamjen dhe të paktën një funksion shtesë sipas zgjedhjes së përdoruesit

SISTEMET PËR REGJISTRIMIN DHE MATJEN E HEMODINAMIKËS

1. EKG sipërfaqësore me një minimum prej 12 kanalesh
2. Minimumi 2 kanale të matjes së presionit invaziv
3. Të paktën 1 kanal matës presioni jo invaziv
4. Ngopja me oksigjen
5. Monitorimi i frymëmarrjes
6. Monitorimi i temperaturës së sipërfaqes së trupit
7. Zgjedhja e kanaleve të shfaqura në ekran, renditja dhe ngjyra e tyre
8. Vëllimi në minutë (me metodën e Fick-ut)
9. Set kabllorsh standarde evropiane EKG, set kabllorsh EKG për monitorim 12 kanalesh, min. 2 pranga të madhësive të ndryshme për matjen e presionit joinvaziv të gjakut
10. Mundësia e konfigurimit të cilësimeve dhe parametrave të rinj (p.sh. përcaktimi i studimeve të reja, alarmet, etj.)
11. Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave për analizë
12. Mundësia e shfaqjes së burimeve video në monitor në sallë
13. Mundësia e analizës FFR
14. Sistemi hemodinamik i integruar plotësisht me një ekran me prekje të instaluar në tryezën e pacientit, me mundësinë e funksionaliteteve të mëposhtme: Mostra, Gradient, EDP, Pullback, EKG, NiBP, Marker, Vital, zero, timer, CO, Fshij, etiketa, peshore, kanale1
15. Sistemi kompjuterik me min. konfigurim procesor me te pakten dy bërthama, 2.3 GHz, 4 GB RAM, 250 GB Hard Disk.
16. Monitor i sheshtë LCD me diagonale të paktën 19 inç, rezolucion 1280×1024, min 2 copë.
17. Maus, tastierë, UPS.

APLIKACIONET softuerike

1. Marrja e valëve EKG me ekran grafik, të sinkronizuar me ekran kardio angiografik në monitor live në sallë dhe në dhomën e kontrollit
2. Mundësia e zgjedhjes dhe ruajtjes së ekranit të të paktën 1 sinjal fiziologjik
3. Aplikim për përmirësimin e shfaqjes së stenteve të arterieve koronare. Mund të përdoret me ose pa përforsim të kontrastit, mund të matet për të përcaktuar madhësinë e stentit ose ndonjë pengesë ose ristenozë të stentit. Kontrolli i aplikacionit duhet të jetë i mundur nga dhoma e kontrollit.
4. Një aplikacion për të përmirësuar vizualizimin e pajisjeve të stentit ose balonës në arteriet koronare në kohë reale, ndërkohë që operatori vendos stentën/balonën në lezion, me marrje të vazhdueshme, të paktën 15 fps.
5. Përvetësimi rrotullues i arteries koronare në dy akse që mund të kryhet në një seancë të vetme përvetësimi duke përdorur një injeksion të vetëm kontrasti. Procedura duhet të jetë në gjendje të fillojë nga salla ose nga dhoma e kontrollit.
6. Aftësia për të kryer matje 2D/3D duke përdorur ekranin me prekje (të montuar në tavolinë) ose aftësinë për të mbivendosur konturin e rrënjës së aortës dhe shenjat në

imazhet fluoroskopike në kohë reale për udhëzim të avancuar të procedurave ndërhyrëse

7. Angiografia rrotulluese 3D që mundëson vizualizimin anatomik 3D të rajoneve me interes si dhe të enëve të gjakut.

8. Aplikim/teknikë e avancuar e softuerit 3D që mbështet matje të standardizuara dhe funksione manuale/automatizuara për të kuptuar ndikimin e vendimeve terapeutike në rezultatin përfundimtar të procedurave cerebrale, periferike, abdominale dhe kardio.

9. Sistemi duhet të mundësojë kalibrimin automatik të objektit në izoqendër, për të shmangur kalibrimin manual.

10. Softuer për analizën sasiore të arterieve koronare (QCA) që mundëson: - njohjen automatike të formës, me mundësinë e redaktimit manual - llogaritjen e përqindjes së stenozës, distancën, matjen e sipërfaqes - kalibrimin automatik dhe manual.

11. Softuer për analizën sasiore të strukturave vaskulare (QVC)

LIDHJET

1. Lidhja DICOM 3.0 (Imazhe dixhitale dhe komunikimet në mjekësi)

2. Përputhshmëria DICOM: Dyqani, Shërbimi i Përkushtimit të ruajtjes, Pyetja/Rikthimi, MPPS, Lista e punës

3. Ruajtja në formatin DICOM në CD/DVD nga tastiera e blerjes

4. Aftësia për të përcjellë automatikisht imazhet në të paktën 5 destinacione DICOM gjatë regjistrimit

MBROJTJA NGA Rrezatimi i PACIENTËVE DHE STAFI

1. Një metodë inteligjente e monitorimit të dozës që përfshin shfaqjen në kohë reale të dozës kumulative sipërfaqësore, si dhe shkallën e dozës dhe shfaqjen e hartës së shpërndarjes së dozës së ngjyrave (me dërgimin në PACS nëpërmjet protokollit DICOM).

2. Të paktën 4 mënyra funksionimi fluoroskopike për të reduktuar dozën për pacientin, me mundësi përzgjedhjeje në tryezën e pacientit

3. Mundësia e shfaqjes më të afërt të kornizës së imazhit aktual të fluoroskopisë

4. Mundësia për një pamje me të afërt të kornizës së fluoroskopisë optike aktuale pa rritur dozen

5. Ruajtja e Raportit të Dozimetrisë së Strukturuar (RSDR) në PACS

6. Mbrojtje transparente nga rrezatimi në suportin e tavanit me min. 0,5 mm Pb

7. Mbrojtja nga rrezatimi në tavolinë me min. 0.5 mm Pb për mbrojtjen e ekstremiteteve të poshtme 2 copë

AKSESORËT

1. Llambë LED e vendosur në mbajtësen e tavanit

2. Mbështetësja e kokës

3. Qëndrim për infuzion

4. Mbështetësit e krahut

5. Kompleti mbështetës i bërrylit

Shënim: Ambienti ku do të instalohet pajisja Angiograf ka lartësinë 286 cm nga dyshemeja në tavan dhe në tavan ka dy trare mbajtës dhe distancë nga dyshemeja deri te trarët është 242 cm.

UPS për mbrojtjen e pajisjes Angiograf

1. UPS On-Line për Pajisjen Angiograf me fuqi dalëse (poëer output) min. 200kVA
2. Koha minimale e autonomisë së UPS it të jetë 10 minuta.

Defibrilator

1. Të ketë të integruara funksionet e defibrilimit, monitorimit, AED dhe pacing
2. Me funksion kardioversioni
3. Me doreza shumëpërdorimshe
4. I pajisur me printer
5. Me mundësi për të zgjedhur pacientë adultë dhe pediatrike
6. Me ekran me ngjyra për shfaqjen e parametrave, madhësia të paktën 8"
7. I pajisur me bateri të brendshme
8. Bateria duhet të jetë e aftë të japë të paktën 200 goditje me të paktën 200J secila
9. Defibrilatori duhet të jete bifazik me fuqi nga fuqi 0-200J
10. Koha e ngarkimit deri në 360J të jetë jo më shumë se 8s
11. Diapazoni matjes së EKG të jetë të paktën nga 15 në 300 bpm

Monitor pacienti

1. Madhësia e ekranit të jetë të paktën 10"
2. Të paraqesë të paktën 3 kurba të ndryshme
3. Të ketë tre kategori pacientësh të zgjedhshëm: adult, pediatrik dhe neonat.
4. I pajisur me bateri të brendshme
5. Bateria të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të paktën 4 orë funksionim të pandërprerë në kushtet e mungesës së furnizimit me energji nga rrjeti
6. I pajisur me printer të brendshëm
7. Të shfaqë trendin tabular prej të paktën 180 orësh
8. Të jetë i pajisur me EKG me 5 fisha
9. Diapazoni I ritmit të zemrës nga 10 deri në 300 bpm
10. Të jetë I pajisur me funksionin e matjes së SpO2
11. . Diapazoni i matjes së SpO2 prej të paktën 0% deri ne 100%
12. Gabimi i matjes së SpO2 të mos jetë më i madh se 3% në diapazonin e SpO2 midis 70 dhe 100%
13. Saktësia e matjes së pulsit të jetë të paktën me e mirë se 3%
14. Të jetë i pajisur me funksionin e matjes së NIBP

15. Intervali për matje automatike të NIBP të jetë i zgjedhshëm të paktën midis 1 min dhe 2 orë
16. Të shfaqë kurbën e respirimit.
17. Diapazoni i matjes së respirimit të jetë të paktën në diapazonin 3 deri 150 rpm.

Shiringë elektrike

- 1.Mënyra e infuzionit: Norma, Koha, Peshë, Sekuenca, Trapezia, ngarkimi i dozës, Mikro,
- 2.Brezi i shpejtësisë së infuzionit: 0.10- 1800.0 (ml / h)
- 3.Saktësia +/-2%,
- 4.Shkalla e Bolus: 0.01-999.0 (ml / h)
- 5.Bolus manual të jetë i disponueshëm gjithmonë
- 6.Niveli i bllokimit automatik : 3 nivele bllokimi,
- 7.Min 15 terapi të kohëve të fundit që duhet të regjistrohen dhe që do të përdoren për infuzion të shpejtë
- 8.Shpejtësia e infuzionit mund të ndryshohet gjatë infuzionit, pa e ndalur këtë të fundit
- 9.Karakteret për shkrimin e ilaçit min 23 karaktere
- 10.Vëllimi i alarmit të zërit: i rregullueshëm për bulëz ajeri dhe për grumbullim ajri
- 11.Kur furnizimi me energji AC / DC është ndërprerë, infuzioni kalon automatikisht në furnizimin me bateri
12. Bateri litium, me kapacitet rezervë jo më pak se 11 orë
13. Kalibrim automatik ose manual i sensorit
- 14.Display me dritë i lexueshëm nga kënde minimumi 40 gradë
- 15.Llojet e shiringave: Të gjitha shiringat standarde nga 2 ml deri 60ml
- 16.Llogaritje automatike e dozës nëpërmjet librarisë së ilaçeve të paracaktuara
- 17.Të ketë mundësi barkodimi për shiringën dhe kontenierin
- 18.Certifikuar nga standardi DIN EN ISO 9001 dhe EN ISO 13485 për të qenë në gjendje të lidhet me XML
- 19.Peshë jo më shumë se 2 kg

Llampë operatore

- 1.Me dy reflektorë
- 2.Intensiteti i ndriçimit të jetë të paktën 160 klux
- 3.Temperatura e ngjyrës të jetë të paktën 4900 gradë Kelvin
- 4.Diametri i reflektoreve të jetë të paktën 60 cm
- 5.Diametri i fushës së ndriçimit të jetë të paktën 30 cm
- 6.E përshtatshme për lartësi tavani (niveli i fiksimit) të paktën 320 cm

Tavolinë sallë me rrota

1. Materiali të jetë çelik inoksidabël
2. Madhësia e syprinës të jetë të paktën 50 cm x 70 cm
3. Me rrota me diametër prej të paktën 8 cm

INJEKTOR KONTRAST

1. Agjent kontrasti plotësisht i automatizuar, i kontrolluar me mikroprocesor dhe me kontroll të volumit, shpejtësisë së rrjedhës, presionit dhe kohës së destinuar për përdorim edhe në dhomën e angiografisë
2. Vëllimi i shiringës së kontrastit min. 99.9 ml
3. Mbushja manuale ose automatike e shiringës me shpejtësi 2 ml/s
4. Mundësia e përdorimit të përsëritur të shiringës në disa pacientë
5. Kontrolluesi manual që lejon injektimin e kontrastit me rrjedhje të ndryshueshme dhe kalibrimin automatik të fillimit/ndalimit të injektimit
6. Sinkronizim me aparatin angiografik
7. Mënyra e aplikimit të kontrastit: fikse ose e ndryshueshme
8. Shpejtësia e rrjedhjes nga 1ml/s në 30ml/s në hapa prej 1ml/s. ose me mire
9. Presioni i rregullueshëm deri në një maksimum prej 1200 PSI,
10. Mundësia e vonimit të injektimit 0-60 s
11. Monitor paneli i kontrollit i ndjeshëm ndaj prekjës me protokolle për procedurat kardiale.
12. Lexues presioni i integruar ose teknologji që ofron monitorim të vazhdueshëm hemodinamik që dërgon automatikisht lexime të presionit invaziv në kohë reale në monitorët e pajisjes angiografike
13. Mundësia e vendosjes së injektorit angiografik, si në stendë ashtu edhe në tavolinë për pacientin.
14. Te gjitha kabllot e funksionimit me energji elektrike si dhe koabllot lidhes te monitorit te komandimit apo te monitorimit. Licensa e Sofëerit të jetë pa limit.

Krevat-barrelë

1. Me lartësi të ndryshueshme me anë të një pompë hidraulike
2. E pajisur me parakolpe në të katër cepat
3. Me mbajtëse për bombolën e oksigjenit
4. Rrota me diametër të paktën 20 cm
5. Me fren qendror
6. Një nga rrotat me frene drejtimi (directional brake) e komandueshme nga 4 pedale anësore
7. Të mundësojë pozicionet Trendelenburg dhe anti-Trendelenburg me të paktën 10 gradë
8. Të suportojë peshën e pacientit prej të paktën 210 kg
9. Përmasat e suprinës të paktën 195 x 75 cm

Karroçë për transport pacienti

1. Gjerësia e ndenjësës të jetë të paktën 45 cm
2. Rrotat e mbrapme të jenë solide dhe me diametër të paktën 24"
3. Rrotat e parme të jenë solide dhe me diametër të paktën 8"
4. Rrotat e mbrapme të jenë të pajisura me frena
5. Me xhep mbrapa shpinore

III.1.3. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe nga verifikimi në seksionin “Kërkesa” në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se në datë 14.10.2025, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK sqarimet dhe argumentimet për ofertën anomalisht të ulët.

III.1.4. Në datë 16.10.2025 me shkresën me lëndë “Kthim përgjigje shkresa 252/176 prot., datë 14.10.2025. Argumentim për ofertën ekonomike”, operatori ekonomik “Health & Light” SHPK ka ngarkuar në rubrikën “Kërkesa” në Sistemin e Prokurimit Elektronik sqarimet/argumentimet mbi ofertën anomalisht të ulët.

III.1.5. Në nenin 93 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”.

III.1.6. Në nenin 82 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime

nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme $MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

PR = 85 % Mo Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PRrrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së. [...].”

III.1.7. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, si edhe nga përllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 38,470,000 lekë pa TVSH, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë

pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfutur ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.8. Nga verifikimi i materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në datë 15.10.2025 ka paraqitur argumentimin/sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK ka paraqitur sqarim narrativ të ofertës si vijon: “[..]Ne disponojmë magazinat tona dhe rrjedhimisht nuk kemi kosto për magazinim. As për vendosjen e tyre në punë nuk kemi kosto pasi ato kryhen nga inxhinierët tanë të trajnuar për këto pajisje.

b) Kompania prodhuese e pajisjes së ofruar, duke qënë se kemi patur disa projekte për pajisje angiografie, na ka ofruar çmime speciale për pajisjen që ne kemi ofruar në këtë procedurë prokurimi. Jemi një kompani lider në këtë fushë me numrin më të madh të sistemeve të instaluar, prodhim i kompanisë Philips të cilat janë në funksion të plotë dhe kanë treguar qëndrueshmëri prej shumë vitesh tashmë.

c) Duke qënë se edhe shoqëria jonë ka qënë e motivuar për ta fituar këtë procedurë prokurimi pasi dëshiron që të prezantojë cilësinë e pajisjes së angiografisë në institucionin tuaj, ka aplikuar një marzh të ulët fitimi për këtë paketë pajisjesh.

d) Mallrat e ofruara janë prodhim origjinal nga prodhues të certifikuar dhe të testuara. Gjithashtu, shërbimet e instalimit, trajnimit dhe mirëmbajtjes do të kryhen nga inxhinierët tanë, të trajnuar nga kompanitë prodhuese të pajisjeve dhe kjo i ul akoma kostat.

e) shoqëria Health&Light shpk operon në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e mjedisit, atë sociale dhe të punës. Ka staf të trajnuar dhe mund të kryejë vetë shërbimet e instalimit dhe mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve pa patur të nevojshme të marrë suport për këto shërbime nga specialistë të kompanisë prodhuese, të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e kostos së pajisje.

f) Ne, Health &Light shpk nuk marrim ndihmë shtetërore (nuk aplikohet).

g) Të gjitha pajisjet që do të furnizohen, do të jenë konform specifikimeve teknike të ofruara. Gjithashtu shoqëria jonë ka realizuar me sukses, në kohë kontratat e lidhura me UNOPS (edhe në periudhën e COVID-19, kur kishte mungesë në furnizime me pajisje mjekësore). Gjatë gjithë periudhës së aktivitetit tonë ne nuk kemi asnjë kontratë të parealizuar. Edhe në ato procedura cmimet tona kanë qënë më të ulëta të ofruara dhe produkte të një cilësie të lartë [...].”

Përveç sqarimit narrativ, Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në mbështetje të deklarimeve më sipër me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka përcaktuar përmes një table një analizë për mallin objekt-prokurimi, duke përcaktuar kosto për njësi, kosto totale, kosto transporti, shpenzime për procedura doganore, si dhe marzhin e fitimit. Gjithashtu bashkëlidhur operatori ekonomik “Health & Light” shpk ka dorëzuar ofertat si dhe komunikimet tregtare (nëpërmjet postës elektronike) lidhur me ofertat e marra nga furnitorët/prodhuesit për mallrat objekt prokurimi, konkretisht aparatura angiografi, UPS për mbrojtjen e pajisjes angiografi, defibrilator, monitor pacienti, shiringë elektrike, llampë operatore, tavolinë salle me rrota, injektor kontrasti, krevat barrelë, karrocë për transport pacienti.

III.1.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës së ngarkuar në SPE datë 15.10.2023, me lëndë “Kthim përgjigje shkresa 252/176 prot., datë 14.10.2025. Argumentim për ofertën ekonomike”, por nuk ka paraqitur analizë kostoje të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementet, pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, ka paraqitur argumentimin e tij në formën e një sqarimi narrativ. Në këtë kuptim KPP gjykon, se shpjegimi narrativ përmes shkresës me nr. 252/176 prot., datë 14.10.2025, e pashoqëruar me dokumente mbështetëse provuese, nuk është e mjaftueshme për autoritetin kontraktor për të krijuar bindjen, se ankimuesi do të sigurojë realizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ka dorëzuar komunikime tregtare nëpërmjet postës elektronike apo ofertat e marra nga prodhuesit, furnitorët, por duke mos mbështetur me prova konkrete si fatura apo deklarata doganore. Gjithashtu operatori

citon si elementet favorizuese faktin që disponojnë magazinat e tyre dhe nuk duhet të paguajnë kosto magazinimi, por nuk vërteton me fakte dhe prova disponimin e kësaj magazine. Operatori ekonomik ka dështuar të provojë me dokumentacion mbështetës argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe pse kjo ofertë e dalë anomalisht krijon bindjen për përmbushjen me sukses të kontratës. Ankimuesi ka detyrimin ligjor, që të prezantojë me dokumentacion provues katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 93 pika 2 të lex specialis si dhe mundësinë (në rastet kur ai mund të marrë ndihmë shtetërore) për plotësimin e kushtit të pestë, që do të garantonin realizimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk është paraqitur dokumentacion provues që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: dorëzimit në mënyrë të detajuar të anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-60614-09-08-2025, me objekt “Furnizim Vendorsje pajisje mjekësore Angiografi, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, me fond limit **66,192,000** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH**, e konvertuar në Euro: 97.14 sipas kursit të këmbimit të datës **08.09.2025: 681.408.28** (gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tete pike njezet e tete) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 09-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Health & Light” ShPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

